



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:227375

Datë: 22.08.2024

Numri i dokumentit: 06074586

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.1402/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Qëndresa Tahiri - Islami me bashkëpunëtoren profesionale Edita Koliqi, në çështjen penale ndaj të pandehurit: V.A për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i besimit nga neni 342 par.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.202/18 dt.24.12.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datën 05.08.2024, në mungesë të Prokurores së shtetit në PTH-Mitrovicë, Ajtene Zoni, të pandehurit V.A dhe mbrojtësit av.Gani Rexha, të dëmtuarit L.H dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar av.Sheremet Ademi. Shqyrtimi, me datë 07.05.2024 shpalli, ndërsa më datë 22.08.2024 këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

V.A, nga babai H... dhe nëna E..., mbiemri i vajzërisë S..., i lindur me datë, me vendbanim në fshatin K..., komuna e M..., i martuar, baba i një fëmijë, punon si shofer, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në mbështetje të nenit 362 par.1 pika 1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës:

REFUZOHET AKUZA

SEPSE : me datë 09.03.2016 rreth orës 13:00, pa autorizim me qëllim që vetit ti sigurojë dobi pasurore, në atë mënyrë që pronarit të kompanisë L.H ia ka bartur betonin me vlerë prej 580 euro deri te lagjja V... tek Sh.M. I ka marr të hollat dhe e ka kthyer komionin në kompani e të hollat të cilat është obliguar t'ia dorëzoj pronarit i ka mbajtur për vete, paratë e njëjta i kanë shërbyer

për të dal jashtë vendit ku ato para të njëjta ia ka marr Policia në Beograd, e atë e ka kthyer në Kosovë.

- Me këtë kishte për të kryer veprën penale - Keqpërdorimi i besimit nga neni 342 par.1 të KPRK-së.
- Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.
- Pala e dëmtuar L.H nga fshati Zh..., komuna e M..., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Aktakuza:

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën, PP.II.nr.202/18 të datës 24.12.2019, kundër të pandehurit; V.A për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i besimit nga neni 342 par.2 të KPRK-së.

Rrjedha e procedurës:

Gjykata, ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 05.08.2024. Shqyrtimit gjyqësor ka qenë publike, është regjistruar në procesverbal dhe është mbajtur në prezencën e palëve; prokurorit të shtetit Ajtene Zoni, të pandehurit V.A dhe mbrojtësit të tij av.Gani Rexha, të dëmtuarit L.H dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar av.Sheremet Ademi. I pandehuri e ka mohuar fajësinë për këtë vepër penale.

Prokurororja e shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë kësaj aktakuze, meqenëse gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetuar dyshimi i bazuar mirë, se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barë sipas kësaj aktakze. Gjendja faktike e përshkruar si në dispozitiv të kësaj aktakuze u vërtetua nga: dëshmitari Sh.M gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 30.07.2024, po ashtu edhe gjatë deklaramit të sotëm të të dëmtuarit – dëshmitarit L.H, i cili në mënyrë kronologjike e përshkruajti rastin i cili ka përputhje të plotë me dispozitivin e aktakuzës. Gjendja faktike vërtetohet po ashtu edhe nga deklarimi i të pandehurit të dhënë në polici me datë 11.03.2016, i cili nuk e mohon se i ka marr shumën e të hollave prej 580 euro, gjithashtu nuk e mohon faktin se ka qenë punëtor i fimres "...", i njëjti përveq tjerave ka deklaruar se pendohet për veprën e kryer penale, duke potencuar po ashtu se do të bëjë marrveshje me prpnarin e fimres

dhe se do të ja jap veturën “passat” që ta mbaj deri sa të i kthej të hollat. Mirëpo shumë prej 580 eruo i pandehuri edhe sot nuk ja ak kthyer, këtë e dëshmoj edhe i dëmtuari-dëshmitari gjatë deklarimit në këtë shyrtrim. Gjendja faktike u vëretuar edhe nga administrimi i provave materiale të propozuara në aktakuzë. Andaj i propozojm gjykatës që të njëjtin ta shpall fajtor për veprën e kryer penale, të njëjtit të is hqiptpj sanksion penal me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit. Ndërsa me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, si rrethanë rënduese të ketë parasyshtë shkallën e përgjegjesisë penale, intesitetin e rrezikimit apo dëmtimit et vlerës së mbrojtur, ndërsa sa i përket rrethanave lehtësuese prokuroria nuk ka gjetur.

I autorizuari i të dëmtuarit, av.Sheremet Ademi në fjalën përfundimtare deklaron: Në tërësi e akceptojm fjalën përkundimtare të prokurorit, duke theksuar se pala e dëmtuar në rastin konkret është ndërmarrja “....”, aksionar i së cilës është i dëmtuari L.H. Meqenëse përveq shumë së theksuar janë përmendur edhe shumë të tjera, që i dëmtuari pretendon që ia ka dhënë të akuzuarit, për të njehta tani nuk paraqesim kërresë pasurore juridike, por bëjmë precizimin e dëmit të provuar në vlerë prej 580 euro.

I dëmtuari L.H në fjalën përfundimtarë deklaron: E përkrahi në tërësi fjalën e të autorizuarit tim dhe te prokurores së shtetit dhe nuk kam se cfarë të shtoj.

Mbrojtësi e të pandehurit V.A, av.Gani Rexha në fjalën përfundimtarë deklaron: Me vëmendje të shtuar e përcjella fjalën e prokurores së shtetit, e cila mbeti në tërësi pranë aktakuzës, e cila sipas mendimit të mbrojtjes, juridikisht është e pa qëndrueshme, e kundërligjshme dhe si e tillë e pa bazuar. Edhe pse vepra penale për të cilin i akuzuari ngarkohet është me një nen dhe dy paragrafe, ndërsa i mbrojturi im ngarkohet me elementet e veprës penale nga paragrafi 2, e që është vepër penale e cilësuar, as në dipozitiv të aktakuzës e as në fjalën përfundimtare prokurorja e rastit nuk e përmendi se ku qëndron elementi kualifikues e kësaj vepre penale, kur dihet mirë dhe u vëretuar saktësisht gjatë shyrtrimit gjyqësor se i akuzuari ka punuar tek i dëmtuari në cilësi të shoferit, pa kontratë me shkrim, me fjalë të tjera punëtor i thjesht pa pasur ndonjë cilësi tjetër apo status tjetër në organizatën ku ka punuar edhe pse ky status duhet të jetë i vecantë për tu dalluar nga punëtorët e tjerë. Jam më se i sigurt se aktakuz është ngritë nga ish prokurori serb, pasi që ka arrit parashkrimi relativ i ndjekjes penale, e për të i ikur përgjegjësise së vjetërsimit të kësaj lëndë, i njëjtit qëllimisht e ngarkon me par.2, edhe pse e ka ditur farë mirë që ky kualifikim i tillë nuk kalon në gjykatë. Se i akuzuari ak qenë punëtor i thejsht ka kurfarrë autorizimesh të vecanta u dëshmuar edhe në bazë të deklaratës së të dëmtuarit të dhënë në shyrtrimin gjyqësor

edhe në polici. Andaj, i propozoj gjyatës që ta refztoj aktakzues për shkak të parashkrimit relativ, cka dëshmohet nga dita kur është keye vepra penale e gjer ne ditën kur ka arritur parashkrimi relativ, mjafton një kohë mjaft e shkurtër që të lexohet Komentari i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i cili thotë se për të ekzistuar kjo vepër penale i akauzuar duhet ta ketë cilësinë ose të avokatit ose të ndonjë kujdestari, cka nuk përkon me gjendjen faktike fare.

I akuzuari V.A në fjalën përfundimtarë deklaroi: E perkrahi në tërësi fjalën e avokatit mbojtës. Ndërsa është deklaruar se në seancën e shqyritimit gjyqësor dëshiron që ta shfrytëzoj të drejtën e tij që të mbrohet në heshtje. Në Procesverbalin mbi marrje në pyetje të të dyshuarit në Stacionin Policor në Mitrovicë me datën 11.03.2016 i pandehuri ka deklaruar se më datën 09.03.2016 ne orarin e punës kam marrë një porosi që të dërgoj beton tek një shtëpi në fshatin V.... E ka dorëzuar betonin dhe nga blerësi ka marrur shumën prej 580 euro, jam kthyer në vendin e punës e kam lënë kamionin dhe e kam marrur veturën time “Pasat”, jam nisur në drejtim të Prishtinës ku veturën e kam lënë në një parking ndërsa unë jam nisur me dal jashtë në të zezën. Të hollat mi ka marrur Policia Serbe ne Beograd me kusht që të mos më dërgjnë në polici. Jam kthyer në Kosove, kam biseduar me pronarin e firmës, që të bëjm një marrvëshje dhe tua kthej paratë, si dhe kam shprehur gatishmërinë që të punoj deri në atë kohë sa e përmbushi vlerën e ketyre parave.

I dëmtuari L.H, në dëshminë e tij për këtë rast, ka deklaruar se ditën kritike kanë pas me dërgu beton tek Sh.M, sipas tij me pompë ka qenë i ngarkuar T.Sh ndërsa me kamionin e dytë ka qenë i ngarkuar V.A, i cili ka qenë punëtor në firmën e tij “...”, sipas tij pasi ia ka dërguar betonin i pandehuri V... i ka marr paratë nga Sh.M ti ndërsa të njëjtat nuk i ka dorëzuar te pronari, i njëjti e ka fikur telefonin dhe më nuk kanë rënë në kontakt me të. Sipas tij vlera e pagesës ka qenë 580 euro pasi kanë qenë 5 kubik, sipas tij nga koha kur ka ndodhur rasti më nuk ia ka kthyer ato para dhe se ai ka punuar në këtë kompani nga vitit 2010, sipas tij i ka dhënë para të pandehurit kur e ka qit fasadën e shtëpisë me sa i kujtohet ia ka dhënë një mijë euro dhe kur dikush nga familjaret e tij ka qenë sëmurë, sipas tij borxhi total është 1920 euro.

Dëshmitari Sh.M në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se data nuk i kujtohet mirëpo e di se ka qenë duke ndërtuar shtëpi në fshatin V..., kur ka kërkuar nga L.H 10 kubik beton, sipas tij 58 euro ka kushtuar një kubik, ku shuma totale ka qenë 580 euro. Sipas tij L.H i ka thënë qe pagesën ia bënë shoferit të fundit që vjen me mikser, i njëjti deklaroi se ja ka dorëzuar parat atij personi dhe e ka nënshkruar faturën, sipas tij më vonë është thirr dhe ka dhënë deklaratën në polici, tutje ka theksuar se të pandehurin e ka parë vetëm 3 minuta deri sa i'a ka dorëzuar të

hollat. Dëshmitarit i është dorëzuar fatura për ta shikuar nga ana e prokurores ku i njëjti ka deklaruar se fatura me numër 14256 e dt.09.03.2016 është fatura që e ka nënshkruar dhe ia ka dorëzuar shumën prej 580 euro shoferit V.A.

Gjykata pas vlerësimit të gjitha provave dhe fakteve në këtë çështje, gjen se nuk përmbushen elementet e kësaj vepre penale nga “paragrafi 2” të nenit 342 të KPRK-së, pasi në rastin konkret i pandehuri nuk ka qenë në cilësinë e kujdestari, avokati apo ndonjë person tjetër që ka detyrim ligjor ndaj pronarit të pasurisë, siç është përcaktuar në këtë paragraf, për më tepër gjykata gjen se i njëjti ka qenë i punësuar si shofer i kamionit dhe përgjegjësia e tij nuk është lidhur me ruajtjen e të hollave.

Gjykata vlerëson se në veprimet e të pandehurit përmbushen të gjitha elementet e veprës penale nga neni 342 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ku është përcaktuar se “*Kushdo që gjatë përfaqësimit apo kujdesit për interesat pasurore të personit tjetër nuk i përmbush detyrimet e tij ose i keqpërdor autorizimet e tij me qëllim që vetes apo personit tjetër t’i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme apo t’i shkaktojë dëm personit interesat pasurore të të cilit ai i përfaqëson ose pasuria e të cilit është nën kujdesin e tij, dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet*”.

Pas vlerësimit të deklaratave të dëshmitarëve që janë dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe pas administrimit të provave, gjykata gjen se i pandehuri me qëllim që vetës ti sjell dobi pasurore nuk i ka përmbushur autorizimet e tija, pra paratë e marra nga Sh.M nuk i ka dorëzuar tek i dëmtuari L.H, duke gjetur kështu se tek i pandehuri janë plotësuar të gjitha elementet e kësaj vepre nga paragraf 1 i nenit 342 të KPRK-së.

Poashtu edhe nga deklarata e të pandehurit V.A e dhënë në Procesverbalin mbi marrje në pyetje të të dyshuarit në Stacionin Policor në Mitrovicë me datën 11.03.2016 e pranon se të hollat që i ka marrur nuk i ka kthyer “*E kam dorëzuar betonin dhe nga blerësi ka marrur shumën prej 580 euro, jam kthyer në vendin e punës e kam lënë kamionin dhe e kam marrur veturën time “Pasat”, jam nisur në drejtim të Prishtinës ku veturën e kam lënë në një parking ndërsa unë jam nisur me dal jashtë në të zezën. Të hollat mi ka marrur Policia Serbe ne Beograd me kusht që të mos më dërgjnë në polici. Jam kthyer në Kosovë, kam biseduar me pronarin e firmës, që të bëjm një marrvëshje dhe tua kthej paratë, si dhe kam shprehur gatishmërinë që të punoj deri në atë kohë sa e përmbushi vlerën e ketyre parave*”.

Gjykata vlerëson se në veprimet e të pandehurit të cilat edhe ai vetë i ka pohuar, mirepo nuk i ka pranuar si veprime të kualifikuara me par.2 të nenit 342 të KPRK-së, janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale me të cilat gjatë përfaqësimit apo kujdesit për interesat pasurore të të dëmtuarit L.H i ka keqpërdorur autorizimet e tij me qëllim që vetes t'i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme.

Ne veprimet e të pandehurit nuk përmbushen elementet e vepres penale Keqpërdorim i besimit nga neni 342 par2 teKPRK-së të cilat konsiderohet se ekzistojnë në rastet kur keqpërdorimin e besimit e **kryen kujdestari ose avokati**. Rrethanë e cilësuar e kësaj forme të veprës penale është cilësia-statusi i posaçëm i kryerësit dhe dobia pasurore që është përfituar me vepër penale, e që në rastin konkret i pandehuri V.A ka pasur statusin e të punsuarit të barabartë me të punësuarit e tjerë dhe në asnjë nga veprimet e tij nuk rezultojn të jenë kryer në cilësinë e kujdestarit apo të avokatit, që kishte për t'i dhënë atij status të vecantë që do t'i bënte veprimet e tij të kualifikuara me par.2 të nenit 342 te KPRK-së.

Sipas vlerësimeve të kësaj Gjykata, dyshimin e bazuar në raport me veprën penale 342 paragrafi 1 të KPRK-se, e vërteton nga provat që i ka deponuar Prokuroria Themelore në Mitrovicë, të bashkangjitur në këtë aktakuzë.

Gjykata rikujton se me rastin e vendosjes nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale, rregull kjo e sanksionuar me nenin 359 paragrafin 2 të KPP-së.

Gjykata në këtë rast ka ndryshuar përshkrimin e gjendjes së fakteve për të pandehurin V.A. Gjendja faktike është ndryshuar pas administrimit të gjitha provave në këtë rast, sepse nuk është provuar gjendja faktike në raport me të pandehurin, siç përshkruhet në aktakuzën e prokurorisë. Si rrjedhojë, kualifikimi ligjor i veprës penale në raport me të pandehurin nuk është adekuat e as në përputhje me gjendjen e fakteve të vërtetuar pas administrimit të të gjitha dëshmive në shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata në përshkrimin faktik të aktgjykimit nuk ka ndryshuar përmbajtjen esenciale të akuzës në raport me kohën, vendin, të pandehurin, përveç se ka ndryshuar gjendjen faktike dhe

kualifikimin ligjor të veprës penale. Gjendja faktike është ndryshuar ashtu siç është vërtetuar me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor..

Andaj, në këtë aktgjykim janë dhënë arsye të mjaftueshme për secilin fakt të vërtetuar. Gjykata rikujton se mundësia për ta ndryshuar kualifikimin ligjor të veprës penale nga ajo në aktakuzë, është e lejueshme dhe e paraparë me ligj dhe kjo lejohet sipas nenit 359 par.2 ku është përcaktuar se “Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës”. dhe 360 paragrafi 1 të KPP-së ku përcaktohet se “Gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor”.

Andaj, Gjykata duke u mbështetur në faktet dhe provat të proceduara në shqyrtimin gjyqësor të cilat i ka vlerësuar me ndërgjegje një nga një dhe në lidhshmëri të të gjitha provave, vjen në përfundim se në veprimet e të pandehurit V.A nuk përmbushen elementet e paragrafit 2 nga neni 342 të KPRK-së.

Pas rikualifikimit të veprës penale, sipas detyrës zyrtare, Gjykata ka shqyrtuar rrjedhën e afatit të parashkrimit absolut të ndjekës penale.

Në nenin 106, par.1, nënpar 1.5 të KPRK-së, është përcaktuar se “ndjekja penale nuk mund të ndërmerret kur të kenë kaluar tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim”. Ndërsa neni 107, par. 8, i të njëjtit Ligj, përcakton se “ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit”.

Rrjedhimisht, gjykata konstaton se nga kryerja e veprës penale e deri më tani ka kaluar më shumë se dyfishi i kohës që kërkohet për arritjen e parashkrimit çka do të thotë se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale në bazë të nenit 107 par. 8, të KPRK-së, sepse brenda kësaj periudhe kohore nuk ka përfunduar ndjekja penale. Saktësisht, parashkrimi absolut i ndjekjes penale në këtë rast penal ka arritur me datë 09.03.2022.

Gjyqtarja e çështjes pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës vlerësojë se kundër të akuzuarit V.A duhet të refuzohet aktakuza për veprën penale Keqpërdorimi i besimit nga neni 342 par.1 të KPRK-së. Në prani të këtyre fakteve e duke vepruar konform nenit 362 par. 1, nën par. 1.3 të KPPK-së, kundër të akuzuarit V.A gjykata mori aktgjykim refuzues për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale ndaj tij.

-Gjykata e ka liruar të pandehurin V.A, nga shpenzimet e procedurës penale, pasi që gjykata ka vendos ta refuzoj akuzën ndaj tij, kjo në bazë të dispozitës së nenit 453 par.1 të KPP-së

- Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt juridiko-civil, gjykata e mori në bazë të nenit 462 par.3 të KPPK-së.

Nga ajo që u tha me lart u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal

P.nr.1402/2019 dt.22.08.2024

Bashkëpunëtoreshë profesionale

Edita Koliqi

Gjyqtarja e vetme gjykyese:

Qëndresa Tahiri- Islami

KËSHILLË JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, pas pranimit të aktgjykimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.